



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA**



GjA.nr. 207/13

19.03.2013

Prishtinë

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2013, jep këtë:

**Mendim juridik**

*Nëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjyqtarit të vetëm apo kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtari i vetëm përkatësisht kryetari i trupit gjykues, vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin, d.m.th., janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohen me ligj, në një situatë të tillë, gjyqtari i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund ta vazhdojë procesin me shqiptimin të dënimit, pa shkuar fare në shqyrtim si dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupin gjykues ta përbëjnë tre (3) gjyqtarë profesionistë.*

**A r s y e t**

Në dispozitën e nenit 248 par. 4 të KPPK thuhet: "Kur gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet e parashikuara nga paragrafi 1 i

këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe, në këtë situatë, gjyqtari i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues i kanë në dispozicion tri mundësi alternative: ta vazhdojnë procesin me shqiptimin e dënimit; të caktojnë seancën, nëse është e nevojshme për të shqyrtuar ndonjë fakt relevant, që ka të bëjë me dënimin, ose pezullon dënimin deri në përfundim të procedurës me prokurorin publik, për të marrë statusin e dëshmitarit bashkëpunues.

Ashtu siç është ndërtuar kjo normë, është e qartë se nuk ka nevojë të shkohet në fjalën përfundimtare, edhe kur kemi të bëjmë me çështje të kompetencës së gjyqtarit të vetëm e as të caktohet shqyrtimi për të plotësuar trupin gjykues për çështjet për të cilat vendos trupi prej tre gjyqtarëve, ngase qëllimi i ligdhënësit të kjo normë ka qenë që procedurën ta bëjë sa më efektive dhe praktike dhe, po mos të ishte ky qëllimi i ligdhënësit, atëherë ai do ta përdorte shprehjen: shkon në fjalën përfundimtare gjyqtari i vetëm apo cakton shqyrtim gjyqësor, kur çështjen duhet ta gjykojë trupi gjykues prej tre gjyqtarëve.

Nëse, me gjithë pranimin e fajësisë në shqyrtimin e parë, do duhej të shkohej në shqyrtim gjyqësor, sikundër mendojnë disa, atëherë përse duhet të ekzistojë shqyrtimi fillestar?. I akuzuari mundet në shqyrtimin gjyqësor ta pranojë fajësinë, (ai ka të drejtë ta pranojë fajësinë në çdo kohë), kur trupi gjykues është i kompletuar dhe nuk do kishte nevojë të shtyhej seanca .Nëse, me gjithë pranimin e ligjshëm të fajësisë në shqyrtimin fillestar, shkohet në shqyrtimin gjyqësor, atëherë duhen aplikuar të gjitha rregullat e shqyrtimit gjyqësor. Ligji nuk parashikon mundësinë e shmangies nga procedurat e parashikuara për shqyrtimin. *Në këtë rast duhet të zbatohen të gjitha rregullat formale, duhet lexuar aktakuza, duhet të pyetet i akuzuari se a e ka kuptuar aktakuzën dhe rishtas duhet të pyetet se a e pranon fajësinë, duke iu dhënë mundësi që të pendohet dhe të mos e pranojë fajësinë, ngase asnjë dispozitë ligjore nuk ia ndalon atij që ta revokojë pranimin e fajësisë.* Nëse shkohet në shqyrtim pas shqyrtimit fillestar, në të cilin i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe nuk respektohen dispozitat që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor, përkatësisht shkohet në fjalë përfundimtare, pa u lexuar aktakuza

dhe pa u pyetur fare i akuzuari, atëherë një procedurë e tillë është paligjshme, ngase ligji nuk parashikon shmangie të tillë procedurale.

Si arsye për të cilën duhet të shkohet në shqyrtim edhe nëse i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, përfaqësuesit e këtij qëndrime e theksojnë faktin se te veprat penale për të cilat duhet të gjykojë trupi gjykues prej tre gjyqtarëve, nuk mund të gjykojë një gjyqtar i vetëm. Një justifikimi i tillë, është i pabazuar. Ligjdhënësi ka parashikuar një shmangie nga norma që rregullon kompetencën funksionale në situatat kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe do ishte absolutisht e panevojshme të shkohet në shqyrtim, si kur kemi të bëjmë me çështje që gjykohen nga gjyqtari i vetëm po ashtu edhe, kur çështja bie në kompetencë të trupit gjykues prej tre gjyqtarëve.

Ligji parashikon që në shqyrtimin gjyqësor, në përputhje me parimin e drejtpërdrejtë - të kontradiktoritetit, të procedohen të gjitha provat relevante për vërtetimin e fakteve. Mirëpo, kur i pandehuri pranon fajësinë, është e mundur shmangia nga ky detyrim ligjor dhe të shkohet drejtpërdrejt në fjalën përfundimtare edhe sa i përket nenit 248.par.4. të KPPK, ligjdhënësi ka parashikuar shmangien nga procedura e rregullt dhe, me qëllim të efikasitetit të procedurës, ka veshur me autorizim gjyqtarin e vetëm që në situata të caktuara të shqiptojë dënimin pa pasur nevojë të shkohet në shqyrtimin gjyqësor për ta kompletuar trupin gjykues.

Sikur ligjdhënësi të mos e kishte veshur me autorizime kryetarin e trupit gjykues (*për vepra penale që gjykohen nga trupi gjykuesi prej tre gjyqtarëve*) që vetë t'ia shqiptojë dënimin të akuzuarit, kur ai në shqyrtimin fillestar e pranon fajësinë, atëherë do të parashikonte me normë ligjore që shqyrtimi fillestar të mbahet në përbërje të plotë, me qëllim të efikasitetit të procedurës penale.

Më 5.3.2013, Prishtinë.

Kryetar i Gjykatës Supreme,

Dr.sc.Fejzullah Hasani

